

## **TEMA: “KUFIZIMET E TË DREJTAVE ZGJEDHORE, SIPAS PRAKTIKËS SË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT”**

### **ABSTRAKT**

Sot, zgjedhjet janë burimi themelor i legjitimitetit të pushtetit. Vetëm zgjedhjet, në të cilat bartësi i së drejtës për votim lirshëm, fshehurazi dhe drejtpërdrejt e realizon këtë të drejtë, mund të vlerësohen si demokratike në pajtim me rregullat dhe standardet ndërkombëtare.

Me të drejtën e barabartë të votës nënkuptohet fuqia e njëjtë e votës së çdo qytetari. Kjo shprehet në formulën demokratike “Një qytetar, një votë”. Vota e çdo qytetari ka peshë të njëjtë dhe është e barabartë me votën e të tjerëve. E drejta e barabartë e votës siguron barazinë e të gjithë qytetarëve në procesin e zgjedhjes.

Garancia për të drejtën e votës universale dhe të barabartë kërkon që individët të lejohen të votojnë mbi bazë jo-diskriminuese dhe pa asnjë dallim të bazuar në faktor social apo ekonomik, paaftësinë fizike, përkatësinë etnike ose bindjen politike. Të gjithë shtetasit që i përmbushin kushtet ligjore do të kenë të drejtë të votojnë në zgjedhje. Atyre që nuk janë shtetas, mund të jepet e drejta për të votuar në zgjedhje në nivel më të ultë se kombëtar, në pajtim me marrëveshjet e aplikueshme ndërkombëtare apo në rrethana tjera.

Garantimi i të drejtës universale për votim apo e drejta elektorale kërkon që individët të kenë të drejtë për të votuar kur të arrijnë moshën e pjekurisë dhe se e drejta e tyre për të votuar nuk mund të pezullohet apo tërhiqet, përveç për arsye të pa aftësisë ligjore (p.sh. në bazë të paaftësisë mendore) ose dënimit për një vepër të rëndë penale.

Në anën tjetër, kujdesi për respektimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut është obligim i shumë organizatave ndërkombëtare, duke filluar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB), Organizata për Bashkëpunim dhe Sigurinë Evropiane, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Gjykata e Strasburgut) si dhe shumë organizata të tjera ndërkombëtare qeveritare dhe joqeveritare.

**Fjalët kyçe: Liritë dhe të Drejtat e Njeriut, Kufizimi i të Drejtave, Gjykata e Strasburgut (GJEDNJ), Platforma juridike (HUDOC), Këshilli i Evropës, OKB, sistemi zgjedhor, të drejtat zgjedhore ose elektorale, etj.**

